



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 655 Prot.

Tiranë, më 08.05 2019

**VENDIM Nr. 105, datë 2.05.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, *Neni 48 dhe VKM Nr. 786, datë 26.12.2018* "Për miratimin e zonave arkeologjike "A" dhe "B", të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre" Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5, datë 2.05.2019, pasi shqyrtoi Raportin e sondazheve arkeologjike të realizuara në kuadër të *projektit për segmentin shtesë "Linja e Optimizimit të Ujësjellësit, Durrës"*- subjekti A.K.U.K. në zonën arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit, paraqitur nga subjekti i licencuar në arkeologji "AD STAR" sh.p.k..

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e sondazheve arkeologjike të realizuara në kuadër të *projektit për segmentin shtesë "Linja e Optimizimit të Ujësjellësit, Durrës"*- subjekti A.K.U.K. në zonën arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit, paraqitur nga subjekti i licencuar në arkeologji "AD STAR" sh.p.k.
2. Të vijojnë punimet e ndërtimit për projektin *"Linja e Optimizimit të Ujësjellësit, Durrës" dhe segmentin shtesë*, duke kryer ndjekjen në mënyrë periodike ditore të punimeve të gërmimit, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur më parë, për këtë projekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)